



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 46 prot.

Kamëz, më/3 .04.2021

V E N D I M

Nr. 38 Datë 13 .04 .2021

**Një ndryshim në VKB nr.28 dt.16.03.2021 për “Miratimin e listës së përfituesve të programit “përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara për vitin 2021”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **13.04.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Vendimin Nr.33 Datë 9.04.2021** në mbështetje të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015“Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23,24, Ligjit 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 73 gërma “d”, VKM nr. 454, datë 3.7.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, në zbatim të shkresës me Nr.657.Prot datë 14.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021”, VKB nr.14 dt.19.02.2021 “Për sistemin e pikëzimit, për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” si dhe relacionit të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të shumës financiare prej 20,760,073 (njëzet milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë në shumën **19,409,567 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë me tvsh**, për vitin 2021, për familjet që banojnë në Bashkinë Kamëz, dhe që përfitojnë nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, dërgimin për bashkëfinancim (60%-40%) në masën prej **11,645,740 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë** nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe **7,763,827 (shtatë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e tetëqind e njëzet e shtatë) lekë** nga **Bashkia Kamëz Gr.0, prog 06180, art 231**, sipas

shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.657 datë 14.01.2021“Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2021”

2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Nën/ Kryetar Këshilli**

**Ali Dauti**

